



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:104605

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06469299

A.nr.1263/22

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses M.I.L, me vendbanim në adresën: Rr."H.B", Komuna e Podujevës, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, me bazë juridike "anulimi i vendimit", pas seancës se shqyrtimit kryesor dhe publik, të mbajtur në prezencë të paditëses e në mungesë të paditurës, më dt. 07.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M.I.L, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i dt.14.03.20222 si i kundërligjshëm dhe paditëses ti njihet e drejta në pensionin familjar dhe atë nga data e paraqitjes së kërkesës.

II. Secila palë bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Gjykata me dt.07.11.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në këtë çështje juridike e cila është mbajtur, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja në padinë e ushtruar pranë kësaj Gjykate më dt.24.05.2022, ka theksuar se paditësja kishte aplikuar tek e paditura më dt.15.12.2022 për njohjen e të drejtës në pension familjar, pasi ndihma sociale i ishte ndërprerë më 17.08.2022 sipas Aktvendimit nr.263084, dhe e pakënaqur

me këtë vendim, paditësja kishte ushtruar ankesën nr.10750 më dt.11.02.2021 drejtuar Këshillit të Ankesave pranë Departamentit të Pensioneve. Tutje ka theksuar se me Aktvendimin e dt.14.03.2022 e paditura kishte refuzuar ankesën e paditëses, me arsyetimin se nuk ka pasur dokumentacion të mjaftueshëm, për të qenë përfituese e pensionit familjar. Më tej ka theksuar se gjatë shqyrtimit të ankesës e paditura ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike duke mos bërë hulumtime dhe ekzaminim të rastit. Pasi paditësja ishte e ve dhe bashkëshorti i saj kishte vdekur më 16.09.2021 dhe kishte tre fëmijë të papunësuar, dhe nuk kishte të ardhura ekonomike sociale për rritjen e fëmijëve, përderisa shtëpia ku jetonte nuk ishte në emër të bashkëshortit, që do të thotë se nuk kishte shtëpi, përderisa dy fëmijë ishin në fakultet ndërsa vajza e vogël në shkollë të mesme. Më tej ka theksuar se kërkon nga Gjykata vërtetimin e fakteve pasi kishte dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfituese e pensionit familjar. Gjithashtu ka theksuar se vendimi i të paditurës përmban të meta që konsistojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të LPA përkatësisht nenit 84 par.2, Ndaj në kuptim të nenit 67 të LKA i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe ti njihet e drejta në pensionin familjar që nga data e paraqitjes së kërkesës.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të parashtruar në këtë gjykatë, me dt.02.05.2024, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Sipas të paditurës, kërkesa e paditëses nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e parapara për njohjen e të drejtës në pension familjar sipas nenit 1,2,4 dhe 12 par.1,2,3 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shtetit. Tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditëses se vendimi është marrë me shkelje ligjore, dhe se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e saja.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 04.11.24, ka administruar provat relevante dhe atë: Deklaratën për bashkësinë familjare nga MPB dt.17.05.2022, dhe dt 26.10.202, Vendimin nga MFPT-Departamenti i Pensioneve i dt.14.03.2022, Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile nr.E256445 dt.21.10.2021, Certifikatën e Vendbanimit nr.B10351138 dt.26.10.2021, Pasqyrën e llogarisë nga Trust dt. Për periudhën 21.10.2020-21.10.2021, Aplikacionin për tërheqjen e kursimeve pensionale nga Trusti nr.A195185, Vërtetimin nga Gjimnazi nga Aleksander Xhovani dt.21.10.2021, Referencën nga King Security per F.L, Kontratën e punës nga King Sercurity per F.L, Certifikatën e Martesës nr.M11269368 dt.e palexueshme, Ankesën e datës 07.02.2022, Vendimin nga MFPT-Departamenti i Pensioneve i dt.12.01.2022, Vërtetimin

për vdekjen nr.487 dt.22.10.2021, Vërtetimin e papunësisë nga MFPT-Agjencia e Punësimit e RKS i dt.23.05.2022, Vërtetimin nr.1709 dt.05.11.2024
Vërtetimin nr.2237/3 dt.04.11.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, rezulton se e paditura, kishte refuzuar kërkesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension familjar.

Me vendimin e dt.14.03.2022 i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses për njohjen e të drejtës në pension familjar.

E pakënaqur me këtë vendim të të paditurës, paditësja ka parashtruar padi me dt. 24.05.2022, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar dhe për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, gjykata i'u referua dispozitës së nenit 3 paragrafi 1.9 të Ligjit Nr. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me të cilin është përcaktuar që: *”Pensioni familjar- është pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj”*. Më pas i 'u referua nenit 12 paragrafi 1 të po këtij ligji, në të cilin është përcaktuar që: *“Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me Vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83)”*. Ndërsa paragrafi 2 parasheh që: *” Sipas paragrafit 1 të këtij neni, të drejtën në pension familjar e realizojnë, anëtarët e ngushtë të familjes, të ish të siguruarit që ka vdekur pas datës 01.01.1999, të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional”*, ndërsa paragrafi 3 përcakton: *“Te drejtën në pension familjar e realizojnë anëtarët e familjes të të punësuarit/ës, që kanë vdekur pas vitit 01.01.1999, si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes*

profesionale, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e stazhit të punës”. Dhe në fund paragrafi 4 përcakton se “Të drejtën në pension familjar, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, e realizojnë: 4.1. bashkëshorti/ja, deri në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, që dëshmojnë se janë në kurorë si dhe nuk janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar; 4.2. Bashkëshorti/ja, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, i shpallur invalid i përhershëm dhe i paaftë për punë; 4.3. fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përkatësisht njëzet e gjashtë (26) vjeçare, nëse ofrojnë dëshmi përkatëse për vijimin e shkollimit të rregullt universitar “.

Nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht Pasqyra e llogarisë nga Trust per periudhën 21.10.2020-21.10.2021, Referenca nga King Security per Fatmir Lushaku, Kontrata e punës nga King Sercurity per Fatmir Lushaku, rezulton se bashkëshorti i paditëses kishte qenë i punësuar në Kompanin për shërbime private të sigurisë KING SECURITY dhe në këtë kompani kishte punuar nga dt.01.11.2020 deri më 31.01.2021, dhe përgjatë kësaj periudhe kishte paguar kontributet në Trust. Ndërsa nga Vertetimi per vdekjen nr.487 dt.22.10.2021, rezulton se bashkëshorti i paditëses Fatmir Lushaku, kishte ndërruar jetë më 16.09.2021. Gjykata vlerëson se nga kwto dshmi nuk ka arritur të vërtetohet fakti se bashkëshorti i paditëses i cili ka vdekur pas datës 01.01.1999, ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional, qw wshtw kriter ligjor, pasi nga e vetmja kontratë e bashkangjitur si dëshmi, vërtetohet se bashkëshorti i paditëses ka vetëm 1vit e 2 muaj, përvojë pune dhe kjo përvojë daton pas vitit 1999.

Prandaj duke qenë se gjykata gjeti se për të ndjerin deri në periudhën 01.01.1999 nuk u dëshmuua përvoja e punës me kontribute prej 15 vitesh, kusht ky i domosdoshëm që më pas të i njihet e drejta në pension familjar bashkëshortes apo fëmijëve, gjykata vlerëson se e paditura drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 12 të paragrafi 1,2,3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, në bazë të të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditëses dhe më pas ankesa për njohjen e të drejtës në Pension Familjar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditëses dhe gjeti se të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së cekur ligjore, është vërtetuar se paditësja nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Bazuar në dispozitën e nenit 7 par.1 të LPK-së përcaktohet se:” *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa sipas nenit 319, paragrafi 1 përcaktohet:“*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”.

Nga kjo, gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi bazuar në nenin 64 të LPK-së

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1263/22, dt.07.11.2024

G j y q t a r j a

Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.